



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.414/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq, Dukagjin Kelmendi nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** si të palejuara ankesat ZL.A.nr.414/2017, ZL.A.nr.415/2017, ZL.A.nr.416/2017, ZL.A.nr.417/2017, ZL.A.nr.418/2017 dhe ZL.A.nr.419/2017, ZL.A.nr.420/2017, ZL.A.nr.421, ZL.A.nr.422/2017, ZL.A.nr.423/2017, ZL.A.nr.424/2017, e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Dukagjin Kelmendi, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 11 (njëmbëdhjetë) ankesa nga Dukagjin Kelmendi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik AAK, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrat e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: Vendvotimi Milloshevë nr.1502/03D, 150e/06R, Raskovë 1513e/01R, Milloshevë 1502/01R, Mazgit 1520/02D, Obiliq 1501e/05R, 1513e/02D, Mazgit 1520/01R, Mazgit i Epërm 1510/02D, 1510/01R.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.414/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas publikimit të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi

përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hedh si të parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankueses nuk e paragjykon çështjen se ankueses i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr.414/2017 më datën 24.10.2017.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*